



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,09.07.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.07.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Grup i Operatorëve Ekonomik Rima engineering group 2004 L.L.C.; Rima Engineering Sh.p.k", për aktivitetin: Furnizimi, rregullimi dhe riparimi i ashensorve "Nr. të Prok: 616 21 028 111 nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet - kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Grup i Operatorëve Ekonomik Rima engineering group 2004 L.L.C.; Rima Engineering Sh.p.k" e datës 08.07.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, rregullimi dhe riparimi i ashensorve Nr. të Prok: 616 21 028 111 kundër Vendimit Të AK-së, të datës 02.07.2021 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.**
- 2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin sipas publikimit të Vendimit të AK-së të datës 02.07.2021.**
- 3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “ Grup i Operatorëve Ekonomik “Rima engineering group 2004 L.L.C.; Rima Engineering Sh.p.k. ” me datë 08.07.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizimi, rregullimi dhe riparimi i ashensorve

Autoriteti Kontraktues, me datë 09.07.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Se pari kërkesa juaj është dorëzuar pas skadimit të afatëve ligjore; dhe

-Se dyti edhe sikur të ishte e afatshme ju sqarojmë se do të ishte plotësisht e pa bazuar, pasi që kërkesa e garancionit është publikuar në Dosjen e tenderit respektivisht në Kushtet e veçanta të kontratës dhe duke marrë parë se e njëjta nuk është kontestuar në fazën para dorëzimit të tenderit, tani nuk mund të kontestohet.

Kërkesat nga dosja e tenderit sipas dispozitave ligjore janë të vetmet në bazë të cilave duhet të kryhet vlerësimi i tenderit dhe këto nuk mund të nderlidhen me asnjë afat apo rregulle tjeter për garancion nga Institucionet tjera.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës, departamentit të prokurimit dhe njësisë së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit